



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.62, datë 31.03.2022

**PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË PËR
POZICIONIN E DREJTUESIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË FIER**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 90 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të Ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 20, pika 8 të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm" të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Mbylljen e procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më datë 31.03.2022.

KRYETAR

ALFRED BALLA

